



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.165/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Rrustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike të propozueses së sigurimit Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Getoar Mjeku dhe Blerim Sallahu, kundër kundërshtarit të sigurimit Dardafon.net L.L.C., me seli në fshatin Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati Virtyt Ibrahimaga nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e propozueses së sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.316/20, të datës 10/08/2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **02/10/2020**, mori këtë:


A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozueses së sigurimit Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr.316/20, të datës 10/08/2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar II.EK.nr.316/20, të datës 10/08/2020 ka vendosur më sa vijon:

- I. Refuzohet në tërësi i pa bazuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë e propozueses Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, ashtu që t'i:
- II. Ndalohet kundërshtarit të sigurimit që:



(A) Të vazhdoj marrëveshjen e mbështetjes së operatorit të rrjetit mobil virtual e lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., me 16 janar 2009 dhe e përfunduar me 30 Korrik 2019.

(B) Të negociojë për të lidhur kontratë tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile.

(C) Të zbatoj çfarëdo kontrate që mund të kenë lidhur gjatë kohës mes përpilimit të kërkesës së paditëses-propozueses dhe shqyrtimit të saj.

III. T'i ndalohet të paditurit-kundërshtarit të sigurimit Dardafon.net L.L.C., të tjetërsojë, të fshehë, të ngarkojë ose të disponojë me pasurit e luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë deri në 264,000,000.00 euro.

IV. T'i ndalohet të paditurit-kundërshtarit të sigurimit Dardafon.net L.L.C., që në cilësinë e kreditorit të kërkoj ose të pranoj nga Ndërmarrja Publike Telekom i Kosovë, sh.a., ose nga aksionari i saj.

(A) Përmbushjen e detyrimit nga vendimi final i Arbitrazhit i datës 09 Dhjetor 2016 nxjerr për rastin 2099/MHM, pranë Tribunalit të Odes Ekonomike Ndërkombëtare (ICC).

(B) Përmbushjen e detyrimeve të tjera që mund të caktohen sipas Marrëveshjes së operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës sh.a., me 16 janar 2009.

IV. Të detyrohet i padituri-kundërshtari i sigurimit që të pezulloj të gjitha veprimet që kanë nisur në kundërshtim me këtë aktvendim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe të caktohet masa e sigurisë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kundërshtari i sigurimit, me propozim që të refuzohet ankesa e propozuesit të sigurimit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.




Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja-propozuesja e sigurimit Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së me seli në Prishtinë, me datën 17/07/2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për vërtetim e nulitetit të Marrëveshjes mbështetëse e operatorit të rrjetit mobil virtual e lidhur në mes të paditurës dhe ndërmarrjes publike Telekom i Kosovës, SH.A., me 16 janar 2009 është e pa vlefshme që nga data e nënshkrimit të saj si dhe ka kërkuar kompensimin e dëmit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e po ashtu krahas padis ka paraqitur edhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e atakuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 të LPK-së dhe duke e arsyetuar aktvendimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i propozueses së sigurimit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) të LPK-së, ngase aktvendimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e propozimit për masë të sigurimit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, po ashtu me një kujdes të shtuar i ka analizuar edhe pretendimet tjera ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime tani për tani nuk qëndrojnë sepse masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadisë dhe kjo masë mund të caktohet po që se propozuesi



i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës se sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t'ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadisë. Në rastin konkret propozuesja e masës së sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete të besueshme se kundërshtari i sigurimit vërtet mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesëpadisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit. Në këtë fazë të procedurës Gjykata nuk ka tagër që të ndërhyjë apo t'iu ndalon palëve që të zbatojnë, të vazhdojnë apo të negociojnë arritjen e ndonjë marrëveshjes në mes tyre, ngase kjo është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve sepse çdo subjekt i së drejtës vendos lirisht të lidh ose të mos lidh një kontratë të caktuar, të zgjedh lirisht personin me të cilin do të lidh kontratën, të caktoj lirisht përmbajtjen e kontratës, formën dhe mënyrën e lidhjes së saj, të vendos lirisht për ndërrimin dhe mënyrën e shuarjes së kontratës dhe ajo që kontraktuesit kanë përcaktuar me kontratë është ligj për ta dhe duhet ta zbatojnë. Mirëpo, edhe pse palët kontraktuese janë të lira të vendosin se me cilin person do ta lidhin kontratën e caktuar dhe cila do të jetë përmbajtja e saj, megjithatë, një liri e tillë e kontraktimit duhet të jetë në suazat e rregullave ligjore. Sipas nenit 122 par.1.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare është paraparë: Shoqëria Aksionare ka kompetencë për të lidhur kontratë, mirëpo kjo nuk nënkupton se ka të drejtë të lidh edhe kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit dhe kjo ndalesë është e sanksionuar me norma juridiko-penale.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave të nenit 208 dhe 209 pika d) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-

Ae.nr.165/20, me datën 02/10/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v

SAKTËSINË E KOPIJES E VËRTËTON
UDHËHEQËSI I SHKRIMORËS SË GJYKATËS
TAÇNOST KOPIJE PËTVRBUJE
KUKUVODIČ SUĐSKE PISARNICE

